



**RAPORT NGA MONITORIMI I TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES  
SË SHFRYTËZUESVE BUXHETOR**

---

**QENDRA PËR ANALIZA EKONOMIKE (QAE)  
INSTITUTI PËR DEMOKRACI "SOCIETAS CIVILIS" - Shkup**

**Instrumenti evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut (EIDHR)**

**2012-2013 Përkrahje për një shoqëri civile prosperuese përmes skemave grantesh në vend**

# RAPORT NGA MONITORIMI I TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES SË SHFRYTËZUESVE BUXHETOR

---

QENDRA PËR ANALIZA EKONOMIKE (QAE)  
INSTITUTI PËR DEMOKRACI "SOCIETAS CIVILIS" - Shkup

**Projekt:** Përmirësim i transparencës dhe llogaridhënies  
përmes buxhetit të bazuar në performanca

**Referenca:** EuropeAid/134-015/L/ACT/MK

Ueb faqe:

[www.cea.org.mk](http://www.cea.org.mk)

[www.idscs.org.mk](http://www.idscs.org.mk)



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian

Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Unionit Evropian.

Shkup, 2014

Botues Qendra për analiza ekonomike - QAE  
Për botuesin Marjan Nikollov  
Titull RAPORT NGA MONITORIMI I  
TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES SË  
SHFRYTËZUESVE BUXHETOR  
Tirazh 200 kopje

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

336.146:352(497.7)(035)

TRENOVSKI, Borçe

Raport nga monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies së  
shfrytëzuesve buxhetoe / [Borçe Trenovski]. - Shkup : Qendra për  
analiza ekonomike - QAE, 2014. - 42 стр. : илустр. ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Содржи и: Shtojca 1,2

ISBN 978-608-4731-18-4

а) Локална самоуправа - Буџет - Транспарентност - Мониторинг -  
Македонија - Прирачници  
COBISS.MK-ID 97401354

Albanian Translator's note:

Common and well-known international words in the field of (public) management, such as performance, output, input, feedback, target, objective, audit, implement (most of the times), have not been translated, in order to avoid any confusion and/or overlapping with other similar words in the text if they had been translated.

## Përmbajtja

Hyrje .....	7
1) TRANSPARENCA E PARAVE PUBLIKE .....	9
Metodologjia e monitorimit.....	9
Transparenca minimale buxhetore .....	9
Transparenca buxhetore rrjedhëse.....	10
Transparenca plotësuese buxhetore.....	11
Transparenca e planeve strategjike, programeve dhe raporteve vjetore .....	12
Transparenca e llogarisë përfundimtare .....	14
Transparenca e auditimit .....	15
Qartësia e programeve të buxhetit.....	16
Transparenca e rezultateve nga realizimi i buxhetit: tregues të autputeve dhe rezultateve .....	16
Transparenca buxhetore e institucioneve.....	17
2) LLOGARIDHËNIA E REZULTATEVE, PERFORMANCAT E SHFRYTËZUESIT BUXHETOR .....	19
Metodologjia e monitorimit.....	19
Njohuria dhe planifikimi në bazë të prioriteteve strategjike dhe objektivave strategjike .....	19
Planifikimi dhe përgatitja e buxhetit nga shfrytëzuesit buxhetor .....	20
Vlerësimi i buxhetit në kuadër të shfrytëzuesit buxhetor .....	22
Informimi për buxhetin e bazuar në performanca .....	23
Llogaridhënia e rezultateve, performancat sipas institucioneve.....	23
<b>KONSTATIMET KYÇE NGA MONITORIMI I KRYER .....</b>	<b>24</b>
Shtojca 1: Pyetësor për monitorimin e transparencës buxhetore të institucioneve .....	27
Shtojca 2: Pyetësor për procedura për llogaridhënie në kuadër të një shfrytëzuesi buxhetor .....	36
FJALOR I TERMAVE TË PËRDORURA .....	41

*Tatimi juaj paguan për shpenzimet  
publike. Qeveritë nuk kanë para të veta.  
Ka vetëm para të tatimpaguesve.*

*Margaret Thatcher 12/10/1979*

*Besoj se garantimi i qasjes publike në  
informatat qeveritare është i  
pazëvendësueshëm  
në afat të gjatë për çdo shoqëri demokratike ...  
nëse funksionarët e publikojnë vetëm atë që  
ato duan të dinë qytetarët, atëherë publiku  
bëhet farsë, a llogaridhënia e pakuptimtë.  
Sisella Bok, filozof, 1982*

*Të nderuar lexues,*

*Ju drejtohem në fillim me dy citate që e pasqyrojnë të kuptuarit tonë për atë se çka janë paratë publike, shpenzimet publike dhe pse është e domosdoshme në një shoqëri demokratike që informatat me të cilat disponon shteti të jenë publike. Konsiderojmë se në Maqedoni pothuajse nuk ka njohuri për atë se mjetet buxhetore me të cilat disponon Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe institucionet tjera shtetërore dhe publike nuk janë mjete financiare të tyre, por siç thotë premierja e mëparshme britanike Margaret Thatcher, ato janë para të tatimpaguesve, sepse qeveritë nuk kanë para të veta.*

*Kështu, vlerësojmë dhe theksojmë se funksionarët shtetëror dhe publik e kanë patjetër të jenë të vetëdijshëm se vazhdimisht duhet t'i lajmërojnë qytetarët the të japin llogari para tyre për atë se me sa para publike disponojnë, si i harxhojnë paratë publike dhe çfarë rezultatesh arrijnë me harxhimin e parave publike.*

*Mu për këtë, në kuadër të QAE-së dhe IDSCS-së kemi kryer monitorim të shkallës së transparencës dhe hapësis së parave publike të shfrytëzuesve buxhetor dhe kërkim se si shfrytëzuesit buxhetor i vlerësojnë efektet dhe rezultatet nga puna e tyre. Shekulli 21, i zhvilluar informatikisht dhe digjitalisht, ofron mundësi të lehta dhe të thjeshta për bartësit e funksioneve shtetërore dhe publike për të arritur hapësi dhe llogaridhënie në harxhimin e parave publike. Me monitorimin e 60 ueb faqeve të institucioneve publike zbuluam se një numër jashtëzakonisht i vogël i institucioneve i përdorin të njëjtat që t'i japin llogari publikut. Të ngjashme janë gjetjet nga pjesa e dytë e kërkimit përmes së cilës kemi konstatuar se në pjesën më të madhe të institucioneve nuk bëhet vlerësim metodologjik të propozimeve buxhetore gjatë krijimit të buxhetit.*

*Ky raport i yni është një nga sërë aktivitetesh që i ndërmarrim për të apeluar tek Qeveria, institucionet shtetërore dhe publike se buxhetet e "tyre" janë subjekt i transparencës, hapësis, llogaridhënies dhe rezultateve nga harxhimi i parave publike.*

*Me respekt,*

*Ekipet e QAE-së dhe IDSCS-së*

## Hyrje

Transparenca dhe llogaridhënia, si dy parime themelore të qeverisjes së mirë, janë kyçe që opinionin e tërë informata dhe pamje për atë se si mblihen, shpërndahen dhe harxhohen paratë publike. Për më tepër, ato gjithashtu janë të domosdoshme për të treguar se çfarë është vullneti dhe synimi i institucioneve publike për informimin e opinionit dhe për ndarjen e këtyre informatave me të.

Duke u nisur nga kjo nevojë për transparencë, Qendra për analiza ekonomike (QAE) dhe Instituti për demokraci “Societas Civilis”- Shkup (IDSCS) kanë kryer monitorim të informatave themelore në lidhje me programet dhe buxhetet e tyre të cilat shfrytëzuesit buxhetor i ndajnë me publikun. Monitorimi kishte për qëllim të masë dhe kuantifikoj transparencën buxhetore, respektivisht fiskale dhe llogaridhënien e shfrytëzuesve buxhetor. Më konkretisht, qëllimi ynë për zbatimin e monitorimit dhe analizën e të dhënave është të japim vlerësim të qartë për atë se sa institucionet shtetërore ndajnë me publikun se sa dhe për çka harxhohen paratë publike. Përveç kësaj, theksin e vëmë në konceptin **vlera për paratë** (“value for money”), respektivisht të tregojmë nëse fare merren parasysht efektet dhe vlerat të cilat arrihen me harxhimet e bëra, apo qëllimi përfundimtar i institucioneve është të zbatohen vetëm aktivitetet e përcaktuara, pa matjen e mëtejshme të efekteve. Jemi të drejtuar në mënyrë direkte kah Qeveria nëpërmjet ministrive dhe institucioneve, si kyçe në parashtrimin e politikave shtetërore. Shkaktarë kryesorë për një veprim të këtillë është përkeqësimi i transparencës buxhetore në vend nga viti në vit, e matur nëpërmjet Inicativës për buxhet të hapur (OBI – Open Budget Initiative) e cila paraqet program kërkimor global që matë hapjen e qeverive në mbarë botën.

QAE dhe IDSCS si institute të cilat kohë të gjatë punojnë në çështje si transparenca buxhetore dhe politikat publike, bujarisht përfshihen në procesin për përmirësim të transparencës buxhetore dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve nëpërmjet matjes së rezultateve, duke krijuar rekomandime, udhëzime dhe vërejtje për gjendjen momentale. Me këtë aktivitet i vazhdojmë aktivitetet e deritanishme lidhur me temën, me qëllim nxitjen e debatit konstruktiv tek opinionin për rëndësinë e transparencës, llogaridhënies dhe hapësisë së institucionit Qeveria e Republikës së Maqedonisë në lidhje me financat publike.

Fillim i veprimit për arritjen e qëllimeve të lartpërmendura ka qenë monitorimi i shfrytëzuesve buxhetor në vend. Monitorimi ka qenë i zbatuar gjatë muajve maj dhe qershor të vitit 2014 dhe e përmbledh gjendjen e evidentuar në atë periudhë, me atë se do të donim të theksojmë se është e mundur në ndërkohë të ketë ndryshime në disa përmbajtje të cilat institucionet i ndajnë me publikun. Transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve analizohet nga dy pika referimi:

- 1) Informata për buxhetin, programet dhe shpenzimet të cilat shfrytëzuesit buxhetor i publikojnë në ueb faqet e tyre, si dhe informata për rezultatet dhe shpenzimet gjatë realizimit të programeve të cilat janë të prezantuara në buxhetet;
- 2) Procedura për llogaridhënie për mjetet e harxhuara buxhetore të cilat përdoren në kuadër të një shfrytëzuesi buxhetor.

Nën informata në lidhje me programet dhe buxhetet e tyre të cilat shfrytëzuesit buxhetor i ndajnë me publikun nënkuptoheshin informata të cilat ato i ndajnë në ueb faqet e tyre. Ueb faqet si pikë referimi për matjen e transparencës dhe llogaridhënies u morën nga disa arsye. Pikërisht, çdo institucion përdor metoda të ndryshme për të informuar publikun për punën e vet. Kështu, mbahen konferenca për shtyp, brifing për gazetarë, dërgohen njoftime për mediat, jepen intervista, zbatohen fushata informative dhe ndahen informata në ueb faqen e institucionit. Për dallim nga format e tjera të informimit, ueb faqja është media e vetme që mund të siguroj platformë të përhershme të informatave e cila është e disponueshme lehtë për publikun e gjerë. Të gjitha informatat të cilat i publikon një institucion në masë të madhe publikohen gjithashtu edhe në ueb faqen e vet e cila ka kapacitet të shërbejë si arkiv i informatave dhe risive. Ueb faqja është në pronësi të shfrytëzuesit buxhetor dhe gjithnjë e më shumë miratohen edhe detyrime ligjore për publikimin e raporteve të ndryshme në të.

Pikë e dytë e referimit kanë qenë procedurat e brendshme për planifikim, transparencë, llogaridhënie dhe rezultatet e buxhetit dhe harxhimeve buxhetore të një institucioni. Gjithashtu, kjo pikë referimi shërben për të mund të bërë analizë bazike të kapacitetit të tanishëm të institucioneve për të filluar me buxhetimin sipas performancave.

Në bazë të këtyre pikave referimi monitorimi dhe raportet e monitorimit përbëhen prej dy pjesëve të veçanta:

- 1) Transparenca e parave publike – informata të ndara publikisht për programet dhe buxhetin e shfrytëzuesit buxhetor;
- 2) Llogaridhënia e rezultateve – procedura të llogaridhënies dhe matjes së rezultateve, respektivisht performancave të shfrytëzuesit buxhetor.



# 1) TRANSPARENCA E PARAVE PUBLIKE

## Metodologjia e monitorimit

Për këtë pjesë, nga gjithsej 91 shfrytëzues buxhetor të renditur në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë, të monitoruar kanë qenë 60 shfrytëzues buxhetor, respektivisht 66%. Pyetësi në bazë të së cilit është monitoruar Transparenca e internetit të institucioneve, përbëhet prej 32 pyetjeve nga të cilat 17 kanë qenë të marra nga pyetësi i Iniciativës për buxhet të hapur (OBI) dhe të përshtatura në kontekstin maqedonas<sup>1</sup>. Përgjigjet e pyetjeve kanë qenë të vlerësuara prej 0 deri 2 pikë, përveç pyetjes së fundit e cila ka qenë e vlerësuar prej 0 deri 5, me çka maksimumi i pikëve që mund të fitohej në pyetësor ka qenë 67.

Të vëzhguara kanë qenë 8 aspekte të mundshme të transparencës buxhetore: Transparenca buxhetore minimale, Transparenca buxhetore rrjedhëse, Transparenca buxhetore plotësuese, Transparenca e planeve strategjike, programeve dhe raporteve vjetore, Transparenca e llogarisë përfundimtare, Transparenca e auditimit, Qartësia e programeve të buxhetit dhe Transparenca e rezultateve nga realizimi i buxhetit: tregues të autputeve dhe rezultateve. Ky raport veçanërisht do t'i prezantoj rezultatet të cilat janë fituar për çdonjë nga këto aspekte.

## Transparenca minimale buxhetore

Transparenca minimale buxhetore e institucionit (pyetjet nga 1 deri 4) nënkupton se institucioni do të publikoj buxhetin rrjedhës, buxhetet e kaluara, si dhe llogarinë përfundimtare të fundit dhe llogaritë përfundimtare nga vitet e mëparshme. Më konkretisht, është monitoruar nëse institucioni e publikon buxhetin për vitin rrjedhës në ueb faqen e vet; a janë të disponueshme buxhetet e mëparshme të institucionit, dhe në qoftë se janë, atëherë për sa vite të kaluara. A janë të disponueshme për të gjitha vitet e mëparshme, për 5 vitet e fundit, për 3 vitet e fundit apo aspak nuk janë të disponueshme. Sipas të njëjtit parim është monitoruar disponueshmëria e llogarisë përfundimtare për vitin e kaluar dhe për vitet e mëparshme.

Monitorimi tregoi se vetëm 1 nga 60 institucionet e vëzhguara e publikojnë buxhetin për vitin rrjedhës në ueb faqet e tyre, që paraqet 2% nga institucionet e

---

<sup>1</sup> Pyetësi për buxhet të hapur, Partneriteti ndërkombëtar buxhetor, qershor 2011 (Open budget questionnaire International Budget Partnership June 2011) [www.internationalbudget.org](http://www.internationalbudget.org)

vëzhguara. Vetëm Ministria e shëndetësisë e publikonë buxhetin për vitin rrjedhës. Gjithashtu, është minimal numri i institucioneve të cilat i publikojnë buxhetet nga vitet e mëparshme, respektivisht vetëm 7,92% nga institucionet e vëzhguara i publikojnë buxhetet e tyre për disa nga vitet e mëparshme.

Vetëm 6 institucione (10%) i publikojnë llogaritë përfundimtare për vitin e mëparshëm. Këto 6 institucione janë: Ministria e financave, Agjencioni për realizimin e të drejtave të bashkësive, Komisioni për mbrojtje nga korrupsioni, Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata me karakter publik, Fondi për sigurim pensional dhe invalidor dhe Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë. Në masë pak më të madhe, më së shpeshti si pjesë e raporteve vjetore, mund të gjenden llogaritë përfundimtare për vitet e mëparshme. Pesëmbëdhjetë institucione (19,17%) i publikojnë llogaritë përfundimtare për disa nga vitet e mëparshme, respektivisht llogaritë përfundimtare për 5 vitet e fundit janë të disponueshme për 13 institucione, kurse në rastin e Komisionit për mbrojtje nga korrupsioni, të disponueshme janë nga formimi i tij.

## Transparenca buxhetore rrjedhëse

Duke pasur parasysh se çdo shfrytëzues buxhetor ka për obligim të përgatisë raporte vjetore dhe gjysmëvjetore, është ekzaminuar nëse raportet mujore publikohen në ueb faqen e shfrytëzuesit buxhetore, sa publikohen ato rregullisht, nëse ato i krahasojnë shpenzimet gjatë vitit rrjedhës me shpenzimet për të njëjtën periudhë vitin e mëparshëm dhe me vlerësimet për të njëjtat shpenzime; si dhe nëse publikohet raporti gjysmëvjetor në të cilin është përfshirë diskutim mbi ndryshimet në pikëpamjet ekonomike nga sjellja e buxhetit (pyetjet nga 14 deri 16).

Vetëm një institucion nga 60 të cilat kanë qenë të monitoruara i publikon raportet mujore për realizimin e mjeteve nga buxheti dhe ai është Fondi për sigurim shëndetësor. Ky institucion është unik edhe për atë se i publikon raportet e këtilla nga viti 2006 dhe atë e bën çdo muaj, me çka ka fituar 2 pikë. Fondi për sigurim shëndetësor është unik edhe në lidhje me treguesin e radhës, respektivisht në raportet mujore bëhet krahasim i shpenzimeve në vitin rrjedhës me vlerësimet për periudhën e njëjtë të paraqitura në buxhet ose me të njëjtën periudhë vitin e mëparshëm, për çka ka fituar 2 pikë. Shkalla e transparencës për raportet mujore lidhur me këto dy pyetje është 1,67%. Përsëri, Fondi për sigurim shëndetësor është

---

***Shembulli i vetëm pozitiv për transparencë të raporteve buxhetore mujore është Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë***

www.fzo.org.mk/default.asp?itemID=9A358208C6BD144FAC0949B83CC94096

Фонд за здравствено осигурување на Македонија

Фонд за здравствено осигурување на Македонија-Побрзо до Вашите права!

Месечен извештај за реализација на средствата од Буџетот на Фондот и на буџетите на ЈЗУ

2014 година

- мај 2014 година (презентации)
- април 2014 година (презентации)
- март 2014 година (презентации)
- февруари 2014 година (презентации)
- јануари 2014 година (презентации)

2013 година

- декември 2013 година (презентации)

---

i vetmi prej 60 institucioneve që publikon raport gjysmëvjetor i cili përfshin diskutim për ekonominë, por mungojnë disa detaje, me çka është vlerësuar me 1,5 pikë. Shkalla e transparencës për raportet gjysmëvjetore është 1,25%.

## Transparenca plotësuese buxhetore

Përveç transparencës buxhetore minimale, është hulumtuar nëse institucioni ndërmerr disa hapa plotësuese për transparencë. Respektivisht, a e publikon buxhetin në formë vizuale të thjeshtësuar me qëllim që ai të jetë i kuptueshëm për qytetarin e thjeshtë i cili nuk ka ekspertizë për lexim të dokumenteve buxhetore, si dhe a janë të publikuara dokumentet buxhetore si të dhëna të hapura (pyetjet 31 dhe 32).

Asnjë institucion (0%) nuk ka bërë përpjekje plotësuese që t'i njoftoj dhe t'i informoj qytetarët për buxhetin e vetë në mënyrë më të thjeshtë dhe vizuale. Nga 5 nivelet lidhur me të dhënat e hapura si formate në të cilat institucionet mund t'i publikojnë dokumentet buxhetore, institucionet e përdorin vetëm pdf formatin. Asnjë institucion nuk i publikon dokumentet buxhetore në nivel tjetër, më të lartë, lidhur me të dhënat e hapura (excel, softuer i hapur, url, metadata). Niveli i transparencës buxhetore si të dhëna të hapura është 11%.

## Transparenca e planeve strategjike, programeve dhe raporteve vjetore

Cilat janë objektivat strategjikë të institucionit, nëpërmjet cilave programe i zbaton dhe çfarë janë rezultatet nga ato programe janë pyetje kyçe për atë se si harxhohen paratë publike. Për këtë arsye është hulumtuar nëse institucioni e publikon planin strategjik për periudhën rrjedhëse, si dhe për periudhat e mëparshme fiskale, a e publikon programin e punës për vitin rrjedhës dhe për vitet e mëparshme, si dhe a janë të publikuara raportet gjysmëvjetore dhe vjetore për vitin e fundit fiskal dhe për vitet e mëparshme. Gjithashtu, është ekzaminuar nëse janë të publikuara kornizat e tyre kohore për sjelljen e planit strategjik dhe programit të punës (pyetja 13 dhe pyetjet nga 24 deri 30).

Asnjë institucion në ueb faqen e vet nuk i publikon kornizat e tija kohore për sjelljen e planit strategjik dhe programit të punës. Niveli i transparencës lidhur me këtë pyetje është zero.


Vetëm 14 institucione publikojnë raporte vjetore dhe gjysmëvjetore mbi realizimin e programeve nga buxhetet për vitin e fundit fiskal. Institucionet nuk publikojnë raporte gjysmëvjetore. Shkalla e transparencës në lidhje me këto raporte është 13,33%.

Në lidhje me atë se a janë të publikuara raportet vjetore dhe gjysmëvjetore mbi realizimin e programeve për vitin e mëparshëm, shkalla e transparencës është më e lartë, edhe atë 13,33%. Monitorimi tregoi se 16 institucione i publikojnë raportet gjysmëvjetore ose vjetore mbi realizimin e programeve për vitin e mëparshëm. Institucioni i vetëm i cili publikon raport gjysmëvjetor është Komisioni për verifikimin e fakteve, i cili për atë është posaçërisht i obliguar me ligj.

Nga ana tjetër, transparenca më largpamëse në retrospektivë për raportin gjysmëvjetor ose vjetor mbi realizimin e programeve për vitet e mëparshme është në nivel më të lartë, edhe atë 24,17%. Nëntëmbëdhjetë institucione publikojnë raporte vjetore për punën e tyre në disa nga vitet e kaluara. Institucionet më të

reja, respektivisht ato të cilat janë të formuara në 10 vitet e kaluara, tentojnë më shumë të publikojnë raporte vjetore. Pothuajse asnjë institucion nuk publikon raporte gjysmëvjetore për punën e vet, respektivisht sikur edhe për pyetjen e mëparshme, raporte të tilla publikon vetëm Komisioni për verifikimin e fakteve.

***Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale është shembull pozitiv për një institucion që i ka publikuar të gjitha raportet vjetore nga formimi i saj.***



Planin strategjik për periudhën rrjedhëse e publikojnë 17 nga 60 institucionet e vëzhguara, me çka është arritur shkalla e transparencës prej 28,33%.

Shtatëmbëdhjetë institucione, gjithashtu, publikojnë plane strategjike për disa nga periudhat e mëparshme fiskale.

Shkalla e transparencës së programit për punë për vitin rrjedhës është 22%, respektivisht vetëm 13 institucione i kanë të publikuara programet për punë të institucioneve të tyre.

Shkalla e transparencës për programet për punë për vitet e mëparshme është pak më e ulët dhe arrin 18,75%, respektivisht 17 institucione i publikojnë programet për punë për disa nga vitet e mëparshme.

## Transparenca e llogarisë përfundimtare

Në veçanti ka qenë e shqyrtuar edhe llogaria përfundimtare e institucionit. A e publikon shfrytëzuesi buxhetor llogarinë përfundimtare, sa kohë pas publikimit të Llogarisë përfundimtare të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë publikohet edhe llogaria përfundimtare e institucionit, a i shpjegon e njëjta dallimet mes shumave të parashikuara dhe të realizuara të të ardhurave, a i shpjegon dallimet mes shumave të parashikuara dhe të realizuara të shpenzimeve, a i shpjegon dallimet mes parashikimeve fillestare makroekonomike për vitin fiskal dhe epilogut konkret për atë vit, dallimet mes vlerësimeve fillestare të output treguesve dhe epilogut konkret për atë vit, dallimet mes vlerësimeve fillestare të treguesve të rezultateve dhe epilogut konkret për atë vit (pyetjet nga 17 deri 22).

Vetëm 4 institucione i publikojnë llogaritë përfundimtare të institucionit të tyre, me çka është konstatuar shkallë e transparencës prej 5,83%.

Duke pasur parasysh se gati asnjë institucion nuk i publikon llogaritë e veta përfundimtare, pyetjet e radhës të cilat kanë të bëjnë me llogarinë përfundimtare kanë qenë të analizuara përmes pamjes në llogarinë përfundimtare nga realizimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Kështu, në lidhje me pyetjen se a i shpjegon llogaria përfundimtare dallimet mes shumave të parashikuara dhe të realizuara të shpenzimeve është konstatuar se shkalla e transparencës së shpjegimit është 39,17%. Në të shumtën e rasteve ekziston ndonjë shpjegim për dallimet në shpenzimet, por mungonin disa detaje ose detaje kyçe.

Në lidhje me pyetjen nëse llogaria përfundimtare i shpjegon dallimet mes shumave të parashikuara dhe të realizuara të të ardhurave, shkalla e transparencës së shpjegimit të këtyre dallimeve është 37,92%.

Drastikisht është më e ulët shkalla e transparencës së shpjegimit të dallimeve mes parashikimeve fillestare makroekonomike për vitin fiskal dhe epilogut konkret për atë vit, respektivisht ajo është 2,92%.

Lidhur me dy pyetje tjera, përkatësisht nëse llogaria përfundimtare i shpjegon dallimet mes vlerësimeve fillestare të output treguesve dhe epilogut konkret për atë vit dhe nëse llogaria përfundimtar i shpjegon dallimet mes vlerësimeve fillestare të treguesve të rezultateve dhe epilogut konkret për atë vit, shkalla e transparencës është zero, duke pasur parasysh se llogaritë përfundimtare nuk tregonin output tregues dhe tregues të rezultateve.

## Transparenca e auditimit

Sikur edhe në Pyetësin për buxhet të hapur, kujdes i është kushtuar edhe asaj nëse janë të publikuara rezultatet nga auditimi i shpenzimeve buxhetore përfundimtare të institucionit pas publikimit të Raportit të auditimit nga ana e Entit shtetëror për revizion të Republikës së Maqedonisë (pyetja 23).

Me përjashtim të Entit shtetëror për revizion që ka publikuar Peer Review të Entit shtetëror për revizion të Republikës së Maqedonisë, përgatitur nga Gjyqi për revizion të Republikës federale të Gjermanisë, asnjë institucion tjetër nuk publikon rezultate nga auditimi i shpenzimeve buxhetore përfundimtare menjëherë pasi që ato janë publikuar nga ana e Entit shtetëror për revizion të Republikës së Maqedonisë.

Shkalla e transparencës së auditimit të shpenzimeve buxhetore përfundimtare të institucionit është minimale, edhe atë 1,25%.

### *I vetmi shembull pozitiv për transparencë të rezultateve nga auditimi është vetë Enti shtetëror për revizion*

ww.dzr.gov.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1089

АЗР ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА

ПОЧЕТНА ГОДИШНИ ПРОГРАМИ ГОДИШНИ ИЗВЕШТАИ

■ За ДЗР

■ Ревизорски извештаи

■ Прописи и стандарди

■ Образец ИЗПМ

■ Извештаи на политичките

PEER REVIEW

PEER REVIEW на Државниот завод за ревизија Република Македонија  
Конечен извештај на Судот за ревизија на Сојузна Република Германија  
(392 KB), 11.07.2012.

## Qartësia e programeve të buxhetit

Monitoruesit kanë shqyrtuar se në çfarë mënyre është i paraqitur buxheti, respektivisht a janë të ndara shpenzimet në buxhetin e institucionit sipas klasifikimit programor, a është e paraqitur struktura e shpenzimeve programore në përqindje të shpenzimeve totale, a janë të paraqitura shpenzimet për vitet e kaluara në buxhetin e institucionit përveç shpenzimeve rrjedhëse dhe a është bërë krahasim i të ardhurave të planifikuara për vitin rrjedhës me të ardhurat nga vitet e mëparshme në buxhetin e institucionit (pyetjet nga 5 deri 8).

Me shqyrtimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2013 është konstatuar se shkalla deri ku buxheti në mënyrë transparente i paraqet shpenzimet sipas programeve është 43%. Është konstatuar se 20 institucione disa shpenzime i paraqesin të ndara sipas klasifikimit programor, kurse 16 institucione të gjitha shpenzimet i paraqesin të ndara sipas klasifikimit programor.

Për asnjë nga buxhetet struktura e shpenzimeve programore nuk është e paraqitur në përqindje të shpenzimeve totale. Shkalla e transparencës në lidhje me këtë pyetje është zero.

Shkallë më të lartë të transparencës, 50,83%, është arritur në lidhje me pyetjen nëse në buxhetin e institucionit janë të paraqitura shpenzimet për vitet e kaluara përveç shpenzimeve rrjedhëse. Nga institucionet e vëzhguara, 57 i paraqesin shpenzimet për vitin e kaluar përveç shpenzimeve rrjedhëse, mirëpo jo edhe për vitet më para.

Shkalla e transparencës buxhetore të institucionit në lidhje me krahasimin e të ardhurave të planifikuara për vitin rrjedhës me të ardhurat nga vitet e mëparshme është 29,17% dhe në të shumtën e rasteve ka të bëjë me krahasimin vetëm me të ardhurat nga viti i mëparshëm.

Transparenca e rezultateve nga realizimi i buxhetit: tregues të  
autputeve dhe rezultateve



Më në fund, theks i veçantë është vendosur në atë nëse janë dhe si janë të paraqitura rezultatet të cilat arrihen me harxhimin e parave publike. A përmban buxheti output tregues për programet shpenzuese dhe nëse përmban për cilën pjesë të shpenzimeve janë të prezantuar tregues të tillë, a janë të dobishëm output treguesit për të vlerësuar ekzekutimin/performancat e programit shpenzues, a janë të dizajnuar output treguesit me sukses që të mundë të vlerësohet nëse ka përparim drejt arritjes së objektivit të caktuar dhe a janë paraqitur/përdorur output treguesit në buxhet së bashku me treguesit e rezultateve (outcome indicators) (pyetjet nga 9 deri 12).

Monitorimi tregoi se asnjë nga këto 60 institucione në buxhetin e tyre nuk prezanton output tregues për programet e shpenzimeve. Shkalla e transparencës për output treguesit të programeve shpenzuese është 0. Duke pasur këtë parasysh, nuk mund të vlerësohet nëse output treguesit do të ishin të dobishëm që të vlerësohet ekzekutimi/performancat e programeve shpenzuese dhe nëse output treguesit janë të dizajnuar me sukses që të mund të vlerësohet nëse ka përparim drejt arritjes së objektivit të caktuar të institucionit, shfrytëzuesit buxhetor. Vlerësimi për të dyja pyetjet është 0.

Gjithashtu, është shqyrtuar se nëse janë të paraqitur output treguesit në buxhet, a janë ato të prezantuara/përdorura së bashku me treguesit e rezultateve (outcome indicators), mirëpo është konstatuar se tek asnjë nga 60 buxhetet nuk janë të paraqitur treguesit e rezultateve. Shkalla e transparencës së treguesve të rezultateve është zero.

## Transparenca buxhetore e institucioneve

Analiza e rezultateve të institucioneve tregon se asnjë nga 60 institucionet shtetërore ose publike të cilat kanë qenë të vëzhguara nuk mund të vlerësohet si transparente lidhur me buxhetin. Përkatësisht, asnjë nga institucionet nuk ka arritur vlerësim pozitiv për transparencën buxhetore as për gjysmën e treguesve.

Nëse i krahasojmë rezultatet e fituara, institucioni më transparent buxhetor është Agjencioni për realizimin e të drejtave të bashkësive tek i cili është vërejtur shkallë e transparencës prej 38%, pas së cilit vjen Fondi për sigurim shëndetësor i cili ka arritur shkallë të transparencës buxhetore prej 34% dhe Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë të informatave me karakter publik që ka arritur shkallë të transparencës buxhetore prej 30%. Ato janë 2 institucionet e vetme të cilat kanë fituar mbi 30%.

Shkallë të transparencës buxhetore mbi njëzet përqind kanë fituar 8 institucione, respektivisht Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i cili ka fituar 28%,

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit me 26%, Ministria e shëndetësisë me 25%, Ministria për shoqëri informatike dhe administratë dhe Enti shtetëror i statistikës kanë fituar nga 24%, Enti shtetëror për revizion me 22%, ndërsa Ministria e ekonomisë ka fituar 21%.

Është vlerësuar se Prokuroria shtetërore e Republikës së Maqedonisë, Ministria e punëve të brendshme dhe Komisioni shtetëror për ankesa për furnizime publike kanë transparencë buxhetore prej 19%, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi prej 18%, Agjencioni për punësim dhe Agjencioni për administratë prej 17%, Ministria për transport dhe lidhje, Ministria për punë dhe politikë sociale dhe Ministria e financave 16%, Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillimi rural prej 14%, Komisioni për mbrojtje të konkurrencës dhe Sekretariati për çështje evropiane prej 13%, Agjencioni për menaxhim me pasuri të konfiskuar dhe Enti shtetëror për mbrojtje të pronësisë industriale prej 12%, ndërsa Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, Ministria e kulturës, Avokati i popullit, Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Komisioni për verifikimin e fakteve kanë transparencë buxhetore prej 10%.

Pastaj, Byroja për zhvillim të arsimit, Drejtoria për zonat zhvillimore teknologjike-industriale, Ministria e punëve të jashtme, Byroja për zhvillim rajonal dhe Sekretariati për legjislacion kanë shkallë të transparencës buxhetore prej 9%. Komisioni shtetëror zgjedhor, Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë fetare, Akademia maqedonase e shkencave dhe arteve dhe Kuvendi i Republikës së Maqedonisë kanë shkallë të transparencës buxhetore prej 8%.

Shkalla e transparencës buxhetore tek Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim, Agjencioni për mallrat rezervë, Agjencioni për ushqim dhe veterinar, Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, Ministria e drejtësisë, Ministria për vetëqeverisje lokale, Ministria e arsimit dhe shkencës është 7%.

Shkalla e transparencës buxhetore e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Prokurorisë publike të Republikës së Maqedonisë, Drejtorisë për rezervat e detyrueshme, Agjencionit për investime të jashtme dhe promovim, Agjencionit për promovimin dhe përkrahjen e turizmit, Drejtorisë së të hyrave publike, Agjencionit për migracion, Agjencionit për të rinj dhe sport, Arkivit shtetëror të Republikës së Maqedonisë është 6%.

Ministria e mbrojtjes, Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, Agjencioni nacional për programe evropiane arsimore, Komisioni rregullator për strehim dhe Qendra për menaxhim me kriza kanë shkallë të transparencës prej vetëm 4%.

Institucioni me më pak transparencë buxhetore është Presidenti i Republikës së Maqedonisë tek i cili është vërejtur shkallë e transparencës prej vetëm 1%.

## 2) LLOGARIDHËNIA E REZULTATEVE, PERFORMANCAT E SHFRYTËZUESIT BUXHETOR

### Metodologjia e monitorimit

Kjo pjesë e monitorimit ka përfshirë caktime për intervistë të drejtpërdrejtë me personat përgjegjës për përgatitjen e buxheteve në secilën nga 60 shfrytëzuesit buxhetor, të cilët kanë qenë të monitoruar edhe në pjesën e parë të monitorimit, për të fituar rezultate më konzistente dhe përgjigje të pyetjeve më konkrete në lidhje me procedurat për llogaridhënie dhe transparencë që ato i përdorin. Për arsye se në procesin e zbatimit të monitorimit pjesa më e madhe e institucioneve nuk u përgjigjën në thirrjen tonë për takim të drejtpërdrejtë për të bërë intervistën, pyetjet e planifikuara në formë të pyetësorit u janë dorëzuar me e-mail dhe me postë. Nga gjithsej 60 shfrytëzues buxhetor të monitoruar, përgjigje për takim apo plotësim të pyetësorit me e-mail ose postë kemi marrë nga 32 institucione, ose 53% e institucioneve që ishin të planifikuar.

Pyetësori, në bazë të së cilës janë monitoruar procedurat për llogaridhënie dhe transparencë që i përdorin institucionet, përbëhet prej 27 pyetjeve. Nga këto, 23 pyetje kanë qenë me përgjigje të mundshme, ndërsa 4 pyetje kanë qenë të llojit të hapur. Përgjigjet e pyetjeve u vlerësuan nga 0 deri 2 pikë dhe numri maksimal i pikëve të pyetësorit ka qenë 46.

Të vëzhguara kanë qenë 4 aspektet e mundshme të llogaridhënies buxhetore: Prioritetet strategjike dhe objektivat strategjike, Planifikimi dhe përgatitja e buxhetit, Vlerësimi i buxhetit dhe Informimi për buxhetin e bazuar në performanca. Ky raport veçanërisht do t'i prezantoj rezultatet që janë fituar për çdonjë nga këto aspekte.

### Njohuria dhe planifikimi në bazë të prioriteteve strategjike dhe objektivave strategjike

A e dinë se cilat janë prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, a sillen plani strategjik dhe objektivat strategjike të institucionit në

bazë të prioriteteve strategjike dhe objektivave prioritare të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, a përballen me vështirësi në lidhjen e planit të buxhetit me objektivat e planeve strategjike, kanë qenë pyetjet që u janë parashtruar institucioneve (pyetjet 1, 2 dhe 15). Nga nëpunësit e intervistuar, 93,8% janë përgjigjur se e dinë se cilat janë prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Njëzet e një institucione planet strategjike dhe objektivat strategjike të tyre i sjellin në bazë të atyre të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (65,6%), ndërsa 8 institucione janë përgjigjur se të njëjtat sillen në përputhje me ato të Qeverisë, por me njëfarë modifikimi (25%).

Në këtë pjesë ka pasur edhe një pyetje të hapur ku njerëzit të cilët kanë qenë të intervistuar është dashur të japin përgjigje të veta. Pyetja kishte të bëjë me atë se në çfarë mënyre sipas mendimit të tyre (lexo nëpunësin) mund të përforcohet lidhja mes planifikimit strategjik dhe procesit buxhetor (pyetja 24). Në këtë pyetje personat përgjegjës për përgatitjen e buxheteve në institucionet janë përgjigjur se lidhja mes planifikimit strategjik dhe procesit buxhetor mund të përforcohet: përmes ekzistimit të një grupi punues që do t'i përpilon objektivat dhe prioritetet strategjike të bazuara në projekte, aktivitete dhe konventa dhe ato do t'i transmeton në nevoja për mjete financiare në formën e projekt-buxhetit të institucionit që i njëjti të miratohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, respektivisht Sekretariati gjeneral dhe Ministria e financave; si dhe përmes vendosjes së treguesve, aktiviteteve dhe rezultateve konkrete dhe specifike të kuantifikuara.

## Planifikimi dhe përgatitja e buxhetit nga shfrytëzuesit buxhetor

Kjo pjesë e pyetësorit ka qenë e dizajnuar me qëllim për të mësuar më shumë rreth mënyrës së planifikimit dhe përgatitjes së buxhetit të institucionit (pyetjet 3-5, 10, 12-14, 16-18, 20, 21 dhe 27). Sipas nëpunësve të intervistuar përgjegjës për përgatitjen e buxhetit të institucionit, Qarkorja buxhetore me kohë u dorëzohet tyre nga ana e Ministrisë së financave. Sa i përket kohës që ju nevojitet për dorëzimin e Kërkesës për aprovim të mjeteve në bazë të Qarkores buxhetore, 23 nëpunës ose 71,9% e të anketuarve janë përgjigjur se koha për dorëzimin e kërkesave është e mjaftueshme, ndërsa 8 nëpunës janë përgjigjur se është e mjaftueshme, por do të ishte mirë nëse zgjat më shumë. Vetëm 3,1% janë përgjigjur se koha nuk është e mjaftueshme. Në lidhje me atë nëse buxheti i institucionit planifikohet në bazë të planit strategjik dhe objektivave strategjike të institucionit, 78,1% e institucioneve buxhetin e vet e planifikojnë në bazë të planit strategjik dhe objektivave strategjike të tyre. Një pjesë e madhe e institucioneve (84,4%) përmbahet në kornizat e tyre kohorë për përgatitjen dhe publikimin e

buxhetit, ndërsa të tjerët janë përgjigjur se u përmbahen shumicës së datave të rëndësishme në kornizën kohore.

Sa i përket asaj se a kanë mungesë të burimeve njerëzore për përgatitjen e buxhetit të institucionit, 28,1% janë përgjigjur se kanë mungesë të burimeve njerëzore, ndërsa të tjerët janë përgjigjur se pritet rritje të burimeve njerëzore (40,6%) ose kanë burime njerëzore të mjaftueshme për përgatitjen e buxheteve (31,3%).

Madje 71,9% e institucioneve të intervistuar janë përgjigjur se nuk kanë program për trajnim të vazhdueshëm të personelit administrativ që merr pjesë në përgatitjen e buxhetit, ndërsa 9,4% janë përgjigjur se edhe ato trajnime që organizohen, nuk organizohen në mënyrë të duhur. Në lidhje me atë nëse institucionet kanë program për trajnim të personelit administrativ për mënyra të reja të prezantimit të buxhetit, madje 90,6% janë përgjigjur se nuk ka programe të tilla, ndërsa vetëm një pjesë e vogël janë përgjigjur se ekzistojnë trajnime të tilla, por nuk realizohen në mënyrë të duhur.

Lidhur me mënyrën e ndarjes së mjeteve, nga të gjitha institucionet e intervistuar, 84,4% e bëjnë ndarjen e mjeteve në bazë të analizës së bërë më parë mbi nevojat, ndërsa pjesa e mbetur prej 15,6% në bazë të harxhimeve historike. Sa i përket mënyrës së përgatitjes së buxhetit, 71,9% janë përgjigjur se buxhetet i përgatisin në bazë të nevojave aktuale dhe në bazë të nevojave në vitet e kaluara, 21,9% janë përgjigjur se buxhetet i përgatisin në bazë të burimeve që nevojiten për përmbushjen e programit dhe pjesa e mbetur prej 6,3% në bazë të buxheteve në vitet e kaluara.

Madje 46,9% e institucioneve nuk i lidhin llogaritë e tyre përfundimtare të buxhetit me treguesit e autpoteve dhe rezultateve të programeve përkatëse, 18,8% nga to këtë e kanë bërë pjesërisht dhe pjesa e mbetur prej 34,3% kanë bërë lidhshmëri.

Në pyetjen se a kanë afate tremujore dhe mujore për përmbushjen e objektivave të programeve, 78,1% e nëpunësve të intervistuar janë përgjigjur se kanë afate të tilla, ndërsa pjesa tjetër prej 21,9% janë përgjigjur se nuk kanë asnjëfarë afati për përmbushjen e objektivave programore. Në lidhje me atë se a ka masa të duhura për trajtim në raste kur paraqiten shpenzime të paparashikuara për buxhetin, 81,3% janë përgjigjur se ekzistojnë, ndërsa 18,8% se masa të tilla nuk ekzistojnë.

Në rast se shpenzimet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dallojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ato të parapara, 62,5% janë përgjigjur

se bëhen ndryshime të duhura në programet, 28,1% janë përgjigjur se pjesërisht bëjnë ndryshime, kurse 9,4% nuk bëjnë ndryshime të duhura në programet.

Edhe për këtë çështje ekzistonte një pyetje e hapur me të cilën dëshironim të marrim informata se si sipas mendimit të tyre do të mund të përmirësohet kalendari buxhetor në Republikën e Maqedonisë. Kështu, sipas personave të intervistuar, përmirësimi i kalendarit buxhetor mund të bëhet nëse: lejohet kornizë e mjaftueshme kohore që shfrytëzuesit buxhetor t'i përgatisin buxhetet e tyre; ndryshohet klasifikimin i të ardhurave dhe shpenzimeve; fillon më herët tërë procesi i planifikimit buxhetor në vitin rrjedhës.

## Vlerësimi i buxhetit në kuadër të shfrytëzuesit buxhetor

Për vlerësimin e propozimeve buxhetore, vetëm 25% e institucioneve përdorin metodologji të përcaktuar. Nga pjesa e mbetur, 56,3% pjesërisht e përdorin metodologjinë e përcaktuar dhe 18,8% nuk e përdorin fare. Në numra kjo do të thotë se vetëm 8 nga 32 institucione të intervistuar përdorin metodologji të përcaktuar për vlerësimin e propozimeve buxhetore. E njëjta gjë ndodh edhe me vlerësimin e arritjes së outputeve nga programet, respektivisht vetëm 21,9% e institucioneve përdorin metodologji të përcaktuar, që do të thotë 7 nga 32 institucione. Të tjerët nuk përdorin metodologji të përcaktuar për vlerësim. Në pyetjen se a bëhet çdo vit vlerësim i planit strategjik, pjesa më e madhe e institucioneve janë përgjigjur pozitivisht në këtë pyetje, por ka pasur institucione që janë përgjigjur se planit strategjik nuk i kushtohet vëmendje e mjaftueshme dhe se kjo bëhet periodikisht.

Në lidhje me atë se a ekziston metodologji për vlerësimin e arritjes së objektivave dhe rezultateve (outcome) të vendosura në planin strategjik të institucionit, vetëm një e katërta e institucioneve të intervistuar (25%) kanë metodologji/akte nënligjore për të vlerësuar arritjen e objektivave dhe rezultateve të vendosura në planin strategjik të institucionit. Sa i përket asaj se a ekziston metodologji për vlerësimin e arritjes së objektivave dhe rezultateve të vendosura në programin e punës së institucionit, vetëm 40,6% e institucioneve kanë dhe përdorin metodologji të tillë.

Vetëm 18,8% e institucioneve ose 6 nga gjithsej 32 institucione të monitoruara janë përgjigjur se kryejnë analizë lidhur me ndryshimin e nevojave të shfrytëzuesve që u përket programi i punës së institucionit. Të tjerët 56,3% janë përgjigjur se bëjnë analizë të pjesërishtme të nevojave, ndërsa 25% janë përgjigjur se nuk bëjnë analizë për këtë qëllim.

Gjithsej 87,5% e institucioneve që janë përgjigjur në pyetësonin, posedojnë procedura të menaxhimit për ndjekjen e pjesës financiare të realizimit të buxhetit, ndërsa pjesa e mbetur prej 12,5% nuk posedojnë procedura të duhura të menaxhimit për ndjekjen dhe vlerësimin e trendëve lidhur me realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, zhvillimin e planeve mujore dhe/ose tremujore për shpenzimet dhe raportimin.

## Informimi për buxhetin e bazuar në performanca

Qëllimi i këtyre pyetjeve ka qenë të dimë nëse dhe sa personat e intervistuar në institucionet dinë dhe a janë të njoftuar me ca mënyra të reja të prezantimit të buxheteve.

Në pyetjen nëse kanë dëgjuar për buxhetin e bazuar në performanca, vetëm 18,8% saktësisht dinin se çka paraqet buxheti i bazuar në performanca, respektivisht vetëm 6 persona të intervistuar. Gjysma, (50%) nga të intervistuarit kanë dëgjuar, por nuk e dinë saktësisht se çka paraqet ai, ndërsa 31,3% ose 10 persona nuk kanë dëgjuar se çka është buxheti i bazuar në performanca.

Personat që kanë qenë të intervistuar dhe të cilët janë përgjigjur se e dinë se çka është buxheti i bazuar në performanca, në përgjithësi nën buxhetin e bazuar në performanca kishin nënkuptuar: përgatitje, programim dhe zbatim të buxhetit në bazë të kriterëve, aktivitete dhe programe të bazuara në rezultate që janë të lidhura me objektivat strategjike të organizatës.

## Llogaridhënia e rezultateve, performancat sipas institucioneve

Analiza e rezultateve sipas institucioneve tregon se asnjë nga 32 institucionet shtetërore që kanë qenë të intervistuar nuk mund të vlerësohen si tërësisht llogaridhënëse sepse asnjëra nga to nuk e ka fituar numrin maksimal të pikëve.

Nëse i krahasojmë rezultatet e fituara, institucioni më llogaridhënës buxhetor është Ministria për shoqëri informatike dhe administratë me gjithsej 38 pikë të fituara ose 83%. Nga 37 pikë ose 80% kanë fituar Komisioni shtetëror për ankesa për furnizime publike, Sekretariati për çështje evropiane dhe Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit. Në masë të madhe llogaridhënës janë Agjencioni për të rinj dhe sport me 78%, Fondi për sigurim shëndetësor me 76%, Agjencioni nacional për programe evropiane arsimore dhe mobilizim me 72% dhe Komisioni shtetëror i zgjedhjeve me 71%. Nga 70% llogaridhënës kanë Akademia maqedonase e shkencave dhe e arteve dhe Ministria e kulturës. Nga 31,5 pikë ose 68% kanë fituar Prokuroria shtetërore e Republikës së Maqedonisë, Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor.

Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave e Republikës së Maqedonisë, sipas përgjigjeve që i dha, fitoi 31 pikë ose 67% nga numri total i pikave që ka mundur t'i fiton për llogaridhënien e saj dhe performancat në punë. Ministria e vetëqeverisjes lokale ka 66%, Drejtorja për të hyrat publike, Ministria e punëve të jashtme dhe Byroja për zhvillim rajonal nga 65% për llogaridhënien dhe performancat e tyre, ndërsa Agjencioni për investime të huaja dhe promovim është 64% llogaridhënës. Ministria për transport dhe lidhje, Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural dhe Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor kanë nga 63%, ndërsa Ministria e punëve të brendshme, Agjencioni për punësim dhe Agjencioni për realizimin e të drejtave të bashkësive nga 61%.

Agjencioni për promovimin dhe përkrahjen e turizmit ka fituar 27 pikë ose 59% për llogaridhënien e tij dhe performancat në punë. Sekretariati për legjislacion, Agjencioni për menaxhim me pasuri të konfiskuar kanë nga 57%, ndërsa Drejtorja për mbrojtje dhe shpëtim ka 54% nga pikët maksimale të cilat ka mundur t'i fiton për punën e vet. Avokati i popullit fitoi 50%.

Më pak se gjysma, apo 49% për llogaridhënien e vet fitoi Ministria e punës dhe politikës sociale. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi fitoi 42%, ndërsa më pak pikë fitoi Komisioni për verifikimin e fakteve. Për llogaridhënien dhe performancat e tija në punë fitoi 14 pikë, që është 30% nga numri maksimal i pikëve.

## KONSTATIMET KYÇE NGA MONITORIMI I KRYER

- Monitorimi kishte për qëllim të masë dhe të kuantifikojë transparencën buxhetore, respektivisht fiskale dhe llogaridhënien e shfrytëzuesve buxhetor.



- Më konkretisht, qëllimi ynë për zbatimin e monitorimit dhe analizën e të dhënave është të japim vlerësim të qartë për atë se sa institucionet shtetërore ndajnë me publikun se sa dhe për çka harxhohen paratë publike.
- Përveç kësaj, theksin e vëmë në konceptin **vlera për paratë** (“value for money”), respektivisht të tregojmë nëse fare merren parasysht efektet dhe vlerat të cilat arrihen me harxhimet e bëra, apo qëllimi përfundimtar i institucioneve është të zbatohen vetëm aktivitetet e përcaktuara, pa matjen e mëtejshme të efekteve.
- **Në pjesën e transparencës së parave publike:**
- Nga gjithsej 91 shfrytëzues buxhetor të renditur në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë, të monitoruar kanë qenë 60 shfrytëzues buxhetor, respektivisht 66%.
- Shembulli i vetëm pozitiv për transparencë të raporteve buxhetore mujore është Fondi për sigurim shëndetësor.
- Raportet mujore të Fondit për sigurim shëndetësor i krahasojnë shpenzimet e vitit rrjedhës me vlerësimet për periudhën e njëjtë të paraqitura në buxhet ose me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.
- Asnjë institucion nuk ka bërë përpjekje plotësuese që t'i njoftoj dhe t'i informoj qytetarët për buxhetin e vetë në mënyrë më të thjeshtë dhe vizuale (të përgatisë Buxhetin qytetarë).
- Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale është shembull pozitiv për një institucion që i ka publikuar të gjitha raportet vjetore nga formimi i saj.
- Shembull i vetëm pozitiv për transparencë të rezultateve nga auditimi është vetë Enti shtetëror për revizion.
- Institucion më pak transparent lidhur me buxhetin është Presidenti i Republikës së Maqedonisë, ku është vërejtur shkallë e transparencës prej vetëm 1%.
- **Në pjesën llogaridhënie të rezultateve, performancat e shfrytëzuesit buxhetor:**
- Kjo pjesë e monitorimit ka përfshirë caktime për intervista të drejtpërdrejta me personat përgjegjës për përgatitjen e buxheteve në secilën nga 60 shfrytëzuesit buxhetor.

- Përgjigjet me propozime të pyetjes se si të përforcohet lidhja mes planifikimit strategjik dhe procesit buxhetor ish-in: ekzistim i një grupi punues që do t'i përpilon objektivat dhe prioritetet strategjike të bazuara në projekte, aktivitete dhe konventa dhe ato do t'i transmeton në nevoja për mjete financiare në formën e projekt-buxhetit të institucionit që i njëjti të miratohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, respektivisht Sekretariati gjeneral dhe Ministria e financave; si dhe përmes vendosjes së treguesve, aktiviteteve dhe rezultateve konkrete dhe specifike të kuantifikuara.
- Përgjigjet me propozime se si mund të përmirësohet kalendari buxhetor në Republikën e Maqedonisë ish-in: të lejohet kornizë e mjaftueshme kohore që shfrytëzuesit buxhetor t'i përgatisin buxhetet e tyre; të ndryshohet klasifikimin i të ardhurave dhe shpenzimeve; të fillon më herët tërë procesi i planifikimit buxhetor në vitin rrjedhës.
- **Rezultate më të hollësishme nga monitorimi:**
- Vetëm 2% nga institucionet shtetërore të monitoruara e kanë të publikuar buxhetin e institucionit për vitin rrjedhës në ueb faqen e tyre;
- Një numër i madh, madje 90% e institucioneve nuk e publikojnë llogarinë përfundimtare;
- Asnjëra nga institucionet në buxhetin e tyre nuk përfshinë output tregues për programet e shpenzimeve;
- Asnjë institucion nuk i publikon kornizat kohore lidhur me përgatitjen e planit strategjik dhe programit për punë;
- Vetëm 13,3% e institucioneve publikojnë raporte vjetore ose gjysmëvjetore për realizimin e programeve nga buxhetet;
- 39,17% e institucioneve nuk publikojnë asnjë shpjegim për dallimin mes shpenzimeve të parashikuara dhe të realizuara;
- 71,67% e institucioneve nuk e publikojnë planin strategjik dhe 78% nuk e publikojnë programin e punës për vitin rrjedhës;
- Asnjë nga institucionet nuk e publikojë buxhetin në formë të thjeshtësuar, të kuptueshme për qytetarët;
- 3,1% nga nëpunësit e intervistuar nuk e dinë se cilat janë prioritetet strategjike të Qeverisë dhe po i njëjti numër i dinë vetëm pjesërisht;

- Vetëm 21,9% e institucioneve përdorin metodologji të përcaktuar për vlerësimin e arritjes së outputeve nga programet;
- Vetëm 34,4% e institucioneve i kanë lidhur llogaritë e tyre përfundimtare të buxhetit me treguesit për outputet dhe rezultatet nga programet përkatëse;
- Nga të gjithë nëpunësit e intervistuar, 28,1% vlerësojnë se ka mungesë të burimeve njerëzore për përgatitjen e buxheteve;
- Gjithsej 90,6% janë përgjigjur se nuk kanë program për trajnim të personelit për mënyra e reja të prezantimit të buxhetit;
- Madje 31,3% nga nëpunësit nuk kanë dëgjuar se çka është buxheti i bazuar në performanca, ndërsa 50% kanë dëgjuar, mirëpo nuk e dinë saktësisht se çka ai paraqet.

Shtojca 1: Pyetësor për monitorimin e transparencës buxhetore të institucioneve

Projekti "Rritje të transparencës dhe llogaridhënies përmes buxhetimit sipas performancave" të Qendrës për analiza ekonomike dhe Institutit për demokraci "Societas Civilis" - Shkup			
<b>a) Transparencë - informata të ndara publikisht për programet dhe buxhetin e shfrytëzuesit buxhetor</b>			
Data:	Pyetje për ndjekjen e ueb faqes së institucionit		
	Emri i institucionit që intervistohet:		
	Emri dhe pozita e nëpunësit që intervistohet:		
	Emri i vëzhguesit:		
Rretho		Vlera e pikëve	Pikat e dhëna
1	<b>A është i disponueshëm buxheti për vitin rrjedhës?</b>		
1 (a)	Po	2	
1 (b)	Jo	0	
2	<b>A janë të disponueshme buxhetet e mëparshme të institucionit?</b>		
2 (a)	Po, të disponueshme janë të gjitha buxhetet nga ekzistimi i institucionit	2	
2 (b)	Të disponueshme janë buxhetet për 5 vitet e fundit	1,5	
2(c)	Të disponueshme janë buxhetet për 3 vitet e fundit	1	
2(ç)	Jo, buxhetet nuk janë të disponueshme <i>(plotësohet pavarësisht se nëse buxheti për vitin rrjedhës është i disponueshëm)</i>	0	
3	<b>A është e disponueshme llogaria përfundimtare për vitin e kaluar?</b>		
3 (a)	Po	2	
3 (b)	Jo	0	
4	<b>A janë të disponueshme llogaritë e mëparshme përfundimtare të institucionit?</b>		
4(a)	Po, të disponueshme janë të gjitha llogaritë përfundimtare nga ekzistimi i institucionit	2	
4(b)	Të disponueshme janë llogaritë përfundimtare për 5 vitet e fundit	1,5	
4(c)	Të disponueshme janë llogaritë përfundimtare për 3 vitet e fundit	1	

4(ç)	Jo, llogaritë përfundimtare nuk janë të disponueshme <i>(plotësohet pavarësisht se nëse llogaria përfundimtare për vitin e kaluar është e disponueshme)</i>	0	
5	<b>A janë të ndara shpenzimet në buxhetin e institucionit sipas klasifikimit programor?</b>		
5 (a)	Të gjitha shpenzimet janë të ndara sipas klasifikimit programor	2	
5 (b)	Disa shpenzime janë të ndara sipas klasifikimit programor	1	
5 (c)	Shpenzimet nuk janë të ndara sipas klasifikimit programor	0	
6	<b>A është e paraqitur struktura e shpenzimeve programore në përqindje të shpenzimeve totale?</b>		
6(a)	Po	2	
6(b)	Jo	0	
7 (OBI)	<b>A janë të paraqitura shpenzimet për vitet e kaluara në buxhetin e institucionit përveç shpenzimeve rrjedhëse?</b>		
7 (a)	Po, të paraqitura janë edhe shpenzimet nga disa vite të mëparshme	2	
7 (b)	Të paraqitura janë shpenzimet vetëm nga një vit i mëparshëm	1	
7 (c)	Jo, nuk janë të paraqitura shpenzimet nga vitet e mëparshme	0	
8 (OBI)	<b>A është bërë krahasim i të ardhurave të planifikuara për vitin rrjedhës me të ardhurat nga vitet e mëparshme në buxhetin e institucionit?</b>		
8 (a)	Po, është bërë krahasim me të ardhurat nga disa vite të mëparshme	2	
8 (b)	Është bërë krahasim vetëm me të ardhurat nga viti i mëparshëm	1	
8 (c)	Jo, nuk është bërë krahasim i të ardhurave	0	
9 (OBI)	<b>A përmban buxheti output tregues për programet shpenzuese?</b>		
9 (a)	Po, output tregues janë të prezantuar për çdo program shpenzues	2	
9 (b)	Output treguesit janë të prezantuar për programet shpenzuese që paraqesin së paku 2/3 e harxhimeve	1,5	

9 (c)	Autput treguesit janë të prezantuar për programet shpenzuese që paraqesin më pak se 2/3 e harxhimeve	1	
9 (ç)	Autput treguesit nuk janë të paraqitur	0	
10 (OBI)	<b>A janë të dobishëm autput treguesit për të vlerësuar ekzekutimin/ performancat e programit shpenzues?</b>		
10 (a)	Autput treguesit janë të dobishëm për të vlerësuar ekzekutimin/ performancat e programit	2	
10 (b)	Autput treguesit janë pjesërisht të dobishëm për të vlerësuar ekzekutimin/performancat e programit	1	
10 (c)	Autput treguesit nuk janë të dobishëm për të vlerësuar ekzekutimin/ performancat e programit	0	
10 (ç)	Autput treguesit nuk janë të paraqitur	0	
11(OBI)	<b>A janë të dizajnuar autput treguesit me sukses që të mund të vlerësohet nëse ka përparim drejt arritjes së objektivit të caktuar?</b>		
11 (a)	Të gjithë autput treguesit janë të dizajnuar mirë	2	
11 (b)	Shumica e autput treguesve janë të dizajnuar mirë	1,5	
11 (c)	Disa autput tregues janë të dizajnuar mirë, por jo të gjithë	1	
11 (ç)	Programet nuk kanë autput tregues ose nuk janë të dizajnuar mirë	0	
12 (OBI)	<b>A janë paraqitur/përdorur autput treguesit në buxhet së bashku me treguesit e rezultateve (outcome indicators)?</b>		
12 (a)	Të gjithë autput treguesit janë përdorur në kombinim me treguesit e rezultateve	2	
12 (b)	Pjesa më e madhe e autput treguesve janë përdorur në kombinim me treguesit e rezultateve	1,5	
12 (c)	Disa autput tregues janë përdorur në kombinim me treguesit e rezultateve	1	
12 (ç)	Autput treguesit nuk janë përdorur së bashku me treguesit e rezultateve	0	

13 (OBI)	<b>A i publikon institucioni kornizat e tija kohore për sjelljen e planit strategjik dhe programit të punës?</b>		
13 (a)	Po, është e publikuar kornizë kohore e detajuar	2	
13 (b)	Po, është e publikuar korniza kohore, por mungojnë disa të dhëna	1,5	
13 (c)	Po, është e publikuar korniza kohore, por mungojnë të dhëna të rëndësishme	1	
13 (ç)	Jo, korniza kohore nuk është e publikuar	0	
14 (OBI)	<b>Sa shpesh institucioni i publikon raportet mujore mbi shpenzimet?</b>		
14 (a)	Raporte mujore mbi shpenzimet publikohen çdo muaj	2	
14 (b)	Raporte mujore mbi shpenzimet publikohen çdo tremujor	1,5	
14 (c)	Raporte mujore mbi shpenzimet publikohen çdo gjashtëmujor	1	
14 (ç)	Raporte mujore mbi shpenzimet nuk publikohen	0	
15 (OBI)	<b>A i krahasojnë raportet mujore shpenzimet e vitit rrjedhës me vlerësimet për periudhën e njëjtë të paraqitura në buxhet ose me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm?</b>		
15 (a)	Po, i krahasojnë shpenzimet e vitit rrjedhës me vlerësimet për periudhën e njëjtë të paraqitura në buxhet dhe me shpenzimet për të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm	2	
15 (b)	Po, i krahasojnë shpenzimet e vitit rrjedhës me vlerësimet për periudhën e njëjtë të paraqitura në buxhet	1,5	
15 (c)	Jo, nuk është bërë krahasim i shpenzimeve/nuk publikohen shpenzimet mujore	0	
16 (OBI)	<b>A publikon institucioni raport gjysmëvjetor për buxhetin në të cilin janë përfshirë ndryshimet në pikëpamjet ekonomike nga sjellja e buxhetit?</b>		
16 (a)	Po, raporti gjysmëvjetor përmban diskutim të gjerë për ekonominë që përfshin parashikim të rishikuar për tërë vitin fiskal dhe efektet mbi buxhetin	2	

16 (b)	Po, raporti gjysmëvjetor përmban diskutim për ekonominë, por mungojnë disa detaje	1,5	
16 (c)	Po, raporti gjysmëvjetor përmban diskutim për ekonominë, por mungojnë detaje të rëndësishme	1	
16 (ç)	Jo, raporti gjysmëvjetor nuk përmban diskutim për ekonominë / raport i tillë nuk përgatitet	0	
17 (OBI)	<b>Sa kohë pas publikimit të Llogarisë përfundimtare të Buxhetit të RM-së nga ana e Ministrit të financave, institucioni e publikon Llogarinë përfundimtare të institucionit?</b>		
17 (a)	Llogaria përfundimtare publikohet në afat prej 6 muajsh ose më herët, pas mbarimit të vitit fiskal	2	
17 (b)	Llogaria përfundimtare publikohet në afat prej 6 deri 12 muajsh ose më herët, pas mbarimit të vitit fiskal	1,5	
17 (c)	Llogaria përfundimtare publikohet 12 muajsh ose më tepër pas mbarimit të vitit fiskal	1	
17 (ç)	Llogari përfundimtare nuk publikohet	0	
18 (OBI)	<b>A i shpjegon Llogaria përfundimtare dallimet mes shumave të parashikuara dhe të realizuara të shpenzimeve?</b>		
18 (a)	Po, është dhënë shpjegim i gjerë për dallimet në shpenzimet, duke përfshirë edhe diskutim përshkrues dhe vlerësime kuantitative	2	
18 (b)	Po, është dhënë shpjegim për dallimet në shpenzimet, duke theksuar dallimet kryesore, por disa detaje mungojnë	1,5	
18 (c)	Po, ekziston shpjegimi, por mungojnë dallimet kyçe	1	
18 (ç)	Jo, nuk është dhënë një shpjegim i tillë	0	
19 (OBI)	<b>A i shpjegon Llogaria përfundimtare dallimet mes shumave të parashikuara dhe të realizuara të të ardhurave?</b>		
19 (a)	Po, është dhënë shpjegim i gjerë për dallimet në të ardhurat, duke përfshirë edhe diskutim përshkrues dhe vlerësime kuantitative	2	
19 (b)	Po, është dhënë shpjegim për dallimet në të ardhurat, duke theksuar dallimet kryesore, por disa detaje mungojnë	1,5	



19 (c)	Po, ekziston shpjegimi, por mungojnë dallimet kyçe	1	
19 (ç)	Jo, nuk është dhënë një shpjegim i tillë	0	
20 (OBI)	<b>A i shpjegon Llogaria përfundimtare dallimet mes parashikimeve fillestare makroekonomike për vitin fiskal dhe epilogut konkret për atë vit?</b>		
20 (a)	Po, është dhënë shpjegim i gjerë për dallimet, duke përfshirë edhe diskutim përshkrues dhe vlerësime kuantitative	2	
20 (b)	Po, është dhënë shpjegim për dallimet, duke theksuar dallimet kryesore, por disa detaje mungojnë	1,5	
20 (c)	Po, ekziston shpjegimi, por mungojnë dallimet kyçe	1	
20 (ç)	Jo, nuk është dhënë një shpjegim i tillë	0	
21 (OBI)	<b>A i shpjegon Llogaria përfundimtare dallimet mes vlerësimeve fillestare të autput treguesve dhe epilogut konkret për atë vit?</b>		
21 (a)	Po, është dhënë shpjegim i gjerë për dallimet, duke përfshirë edhe diskutim përshkrues dhe vlerësime kuantitative	2	
21 (b)	Po, është dhënë shpjegim për dallimet, duke theksuar dallimet kryesore, por disa detaje mungojnë	1,5	
21 (c)	Po, ekziston shpjegimi, por mungojnë dallimet kyçe	1	
21 (ç)	Jo, nuk është dhënë një shpjegim i tillë	0	
22 (OBI)	<b>A i shpjegon Llogaria përfundimtare dallimet mes vlerësimeve fillestare të treguesve të rezultateve dhe epilogut konkret për atë vit?</b>		
22 (a)	Po, është prezantuar shpjegim i gjerë për dallimet, duke përfshirë edhe diskutim përshkrues dhe vlerësime kuantitative	2	
22 (b)	Po, është prezantuar shpjegim për dallimet, duke theksuar dallimet kryesore, por disa detaje mungojnë	1,5	
22 (c)	Po, ekziston shpjegimi, por mungojnë dallimet kyçe	1	
22 (ç)	Jo, nuk është dhënë një shpjegim i tillë	0	

23 (OBI)	<b>A janë të publikuara rezultatet nga auditimi i shpenzimeve buxhetore përfundimtare të institucionit pas publikimit të Raportit të auditimit nga ana e Entit shtetëror për revizion të Republikës së Maqedonisë?</b>		
23 (a)	Llogaritë përfundimtare të audituara shpallen publikisht 6 muaj ose më pak pas publikimit të Raportit të auditimit nga ana e Entit shtetëror për revizion	2	
23 (b)	Llogaritë përfundimtare të audituara shpallen publikisht në afat prej 6 deri 12 muajsh pas publikimit të Raportit të auditimit nga ana e Entit shtetëror për revizion	1,5	
23 (c)	Llogaritë përfundimtare të audituara shpallen publikisht në afat prej 12 deri 24 muajsh pas publikimit të Raportit të auditimit nga ana e Entit shtetëror për revizion	1	
23 (ç)	Llogaritë përfundimtare të audituara shpallen publikisht pas më shumë se 24 muajve ose fare nuk publikohen	0	
24	<b>A janë të publikuar raporti gjysmëvjetor dhe ai vjetor mbi realizimin e programeve nga buxhetet për vitin e fundit fiskal?</b>		
24 (a)	Po, të publikuar janë edhe raporti gjysmëvjetor edhe ai vjetor	2	
24 (b)	I publikuar është vetëm raporti gjysmëvjetor ose vetëm ai vjetor	1	
24 (c)	Nuk janë të publikuar	0	
25	<b>A është i publikuar raporti gjysmëvjetor ose ai vjetor mbi realizimin e programeve:</b>		
25 (a)	Për të gjitha vitet e mëparshme	2	
25 (b)	Për 5 vitet e fundit	1,5	
25 (c)	Për 3 vitet e fundit	1	
25 (ç)	Nuk janë të disponueshëm	0	
26	<b>A është i publikuar raporti gjysmëvjetor ose ai vjetor mbi realizimin e programeve për vitin e mëparshëm?</b>		
26 (a)	Po, të publikuar janë edhe raporti gjysmëvjetor edhe ai vjetor mbi realizimin e programeve në vitin e mëparshëm	2	
26 (b)	I publikuar është vetëm raporti gjysmëvjetor ose vetëm ai vjetor mbi realizimin e	1	

	programeve në vitin e mëparshëm		
26 (c)	Nuk është i publikuar as raporti gjysmëvjetor as ai vjetor mbi realizimin e programeve në vitin e mëparshëm	0	
27	<b>A e publikon institucioni planin strategjik për periudhën rrjedhëse?</b>		
27 (a)	Po	2	
27 (b)	Jo	0	
28	<b>A i publikon institucioni planet e veta strategjike?</b>		
28 (a)	Po, të disponueshme janë planet strategjike për 5 periudhat fiskale të fundit	2	
28 (b)	Po, të disponueshme janë planet strategjike për 3 periudhat fiskale të fundit	1,5	
28 (c)	Po, i disponueshëm është plani strategjik, por vetëm për periudhën fiskale të fundit	1	
28 (ç)	Jo, planet strategjike nuk janë të disponueshme	0	
29	<b>A e publikon institucioni programin e punës për vitin rrjedhës?</b>		
29 (a)	Po	2	
29 (b)	Jo	0	
30	<b>A i publikon institucioni programet për punë për vitet e mëparshme:</b>		
30 (a)	Po, për 5 vitet e fundit	2	
30 (b)	Po, për 3 vitet e fundit	1,5	
30 (c)	Po, mirëpo vetëm për vitin e fundit	1	
30 (ç)	Nuk është i disponueshëm	0	
31	<b>A e publikon institucioni buxhetin në formë vizuale të thjeshtësuar?</b>		
31 (a)	Po, buxheti është i botuar në formë vizuale të thjeshtësuar	2	
31 (b)	Po, buxheti është i botuar në formë vizuale të thjeshtësuar, megjithatë nuk është mjaft i kuptueshëm	1	
31 (c)	Jo	0	
32	<b>Dokumentet buxhetore që janë të publikuara a janë si të dhëna të hapura?</b>		
32 (a)	Po, në të gjitha 5 nivelet (pdf, excel, csf, txd, ods)	5	

32 (b)	Po, në 4 nivele (pdf, excel, csf, txd)	4	
32 (c)	Po, në 3 nivele (pdf, excel, csf)	3	
32 (ç)	Po, në 2 nivele (pdf, excel)	2	
32 (d)	Po, në një nivel (pdf)	1	
32 (dh)	Dokumentet buxhetore nuk janë të publikuara	0	
		Gjithsej pikë të mundshme	Gjithsej pikë të fituara
		67	
<b>Shkalla e transparencës së buxhetit</b>			

Shtojca 2: Pyetësor për procedura për llogaridhënie në kuadër të një shfrytëzuesi buxhetor

## 6) Procedura për llogaridhënie të cilat përdoren në kuadër të një shfrytëzuesi buxhetor

Data: Pyetje për intervista në institucion

<b>Emri i institucionit që intervistohet:</b>			
<b>Emri dhe pozita e nëpunësit që intervistohet:</b>			
<b>Emri i intervistuesit:</b>			
<b>Rretho</b>		<b>Vlera e pikëve</b>	<b>Pikat e dhëna</b>
1	A e dini cilat janë prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë?		
1(a)	Po	2	
1(b)	Pjesërisht	1	
1(c)	Jo	0	
2	A sillen plani strategjik dhe objektivat strategjike të institucionit tuaj në bazë të prioriteteve strategjike dhe objektivave prioritare të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë?		
2(a)	Po	2	
2(b)	Po, me njëfarë modifikimi	1	
2(c)	Jo	0	
3	A ju dorëzohet në kohë Qarkorja buxhetore nga ana e Ministrisë së financave?		
3(a)	Po	2	
3(b)	Jo, me vonesë	0	
4	A është e mjaftueshme koha për dorëzimin e Kërkesave për aprovim të mjeteve në bazë të Qarkores buxhetore?		
4(a)	Po	2	
4(b)	Është e mjaftueshme, por do të jetë më volitshëm nëse zgjat më shumë	1	
4(c)	Nuk është e mjaftueshme	0	
5	A planifikohet buxheti i institucionit në bazë të planit strategjik dhe objektivave strategjike të institucionit?		
5(a)	Po	2	
5(b)	Pjesërisht	1	
5(c)	Jo	0	
6	A përdorni metodologji të përcaktuar për vlerësimin e propozimeve buxhetore?		
6(a)	Po	2	
6(b)	Pjesërisht	1	
6(c)	Jo	0	

7	A përdorni metodologji të përcaktuar për vlerësimin e arritjes së autpoteve nga programet?		
7(a)	Po	2	
7(b)	Pjesërisht	1	
7(c)	Jo	0	
8	A ekzistojnë akte nënligjore dhe/ose metodologji për të vlerësuar se në çfarë mase institucioni në vitin e kaluar i ka arritur objektivat dhe rezultatet (outcome) të përcaktuara në planin strategjik të institucionit?		
8(a)	Po	2	
8(b)	Pjesërisht	1	
8(c)	Jo	0	
9	A ekzistojnë akte nënligjore dhe/ose metodologji për të vlerësuar se në çfarë mase institucioni në vitin e kaluar i ka arritur objektivat dhe rezultatet (outcome) të përcaktuara në programin për punë të institucionit?		
9(a)	Po, edhe për objektivat edhe për programet	2	
9(b)	Po, mirëpo vetëm për objektivat	1	
9(c)	Po, mirëpo vetëm për programet	1	
9(ç)	Jo	0	
10	A keni burime njerëzore të mjaftueshme për përgatitjen e buxheteve?		
10(a)	Po	2	
10(b)	Është e paraparë të rriten burimet njerëzore, por kjo ende nuk është bërë	1	
10(c)	Jo	0	
11	A kryeni analizë lidhur me ndryshimin e nevojave të shfrytëzuesve që u përket programi i punës së institucionit?		
11(a)	Po	2	
11(b)	Po, në një masë të caktuar	1	
11(c)	Jo	0	
12	A keni afate tremujore dhe mujore për përmbushjen e objektivave të programeve?		
12(a)	Po, ka afate tremujore dhe mujore	2	
12(b)	Ka vetëm afate tremujore ose vetëm afate mujore	1	

12(c)	Nuk ka as afate tremujore as afate mujore	0	
13	A keni program për trajnim të vazhdueshëm të personelit administrativ në institucionin tuaj që merr pjesë në përgatitjen e buxhetit?		
13(a)	Po, kemi trajnime	2	
13(b)	Po, kemi, por nuk realizohen në mënyrë të duhur	1	
13(c)	Jo	0	
14	A keni program për trajnim të personelit administrativ në institucionin tuaj që merr pjesë në përgatitjen e buxhetit për mënyra të reja të prezantimit të buxhetit?		
14(a)	Po, për përgatitje të buxheteve me output tregues (output indicators) dhe tregues të rezultateve (outcome indicators)	2	
14(b)	Po, mirëpo nuk realizohen në mënyrë të duhur	1	
14(c)	Jo, nuk kemi trajnime për mënyra të reja për prezantim të buxhetit	0	
15	A përballemi me vështirësi në lidhjen e planit të buxhetit me objektivat e planeve strategjike?		
15(a)	Nuk ka vështirësi, i mjaftueshëm është plani buxhetor	2	
15(b)	Nuk ka mjete të mjaftueshme për arritjen e objektivave	1	
15(c)	Objektivat në planin strategjik nuk janë mjaft të qarta	0	
16	A janë të lidhura shpenzimet në Llogarinë përfundimtare të buxhetit me output tregues dhe tregues të rezultateve nga programet përkatëse?		
16(a)	Po, të lidhura janë me treguesit e rezultateve, apo edhe me output treguesit	2	
16(b)	Pjesërisht, të lidhura janë vetëm me output treguesit	1	
16(c)	Jo	0	
17	A bëhet ndarja e mjeteve në bazë të analizës së bërë më parë mbi nevojat ose në bazë të harxhimeve historike nga vite të kaluara?		
17(a)	Në bazë të analizës së bërë mbi nevojat	2	
17(b)	Në bazë të harxhimeve historike	1	

18	A janë të parapara masa të duhura për trajtim në raste kur paraqiten shpenzime të paparashikuara për buxhetin?		
18(a)	Po	2	
18(b)	Jo	0	
19	A keni siguruar procedura të duhura të menaxhimit (ndjekje dhe vlerësim të trendëve lidhur me realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, zhvillim të planeve mujore dhe/ose tremujore të shpenzimeve, raportim dhe ngjashëm) për ndjekjen e pjesës financiare të realizimit të buxhetit?		
19(a)	Po	2	
19(b)	Disa nga të përmendurat	1	
19(c)	Jo	0	
20	Në rast kur shpenzimet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dallojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ato të parapara, a bëhen përkatësisht ndryshime në programet?		
20(a)	Po	2	
20(b)	Pjesërisht	1	
20(c)	Jo	0	
21	A përgatiten buxhetet në bazë të burimeve që nevojiten për përmbushjen e programit ose në bazë të buxheteve në vitet e kaluara?		
21(a)	Bazuar në të dyja	2	
21(b)	Në bazë të burimeve që nevojiten për përmbushjen e programit, planit operativ	1,5	
21(c)	Në bazë të buxheteve në vitet e kaluara	1	
<b>PYETJE PLOTËSUESE - përgjigje përshkruese, pa pikë</b>			
22	A keni dëgjuar për buxhetin e bazuar në performanca?		
22(a)	Po, e di shumë mirë se çka është buxheti i bazuar në performanca	2	
22(b)	Po, mirëpo nuk di mjaft	1	
22(c)	Jo, nuk di dhe nuk kam dëgjuar	0	
23	Çka nënkuptoni nën buxhetin e bazuar në performanca?		



24	Sipas mendimit tuaj në çfarë mënyre mund të përforcohet lidhja mes planifikimit strategjik dhe procesit buxhetor?		
25	Si mendoni se mund të përmirësohet kalendari buxhetor në Republikën e Maqedonisë?		
26	A bëhet çdo vit vlerësim i planit strategjik?		
27 (OBI)	A përmbahet institucioni juaj në kornizën e saj kohore për përgatitjen dhe publikimin e buxhetit?		
27 (a)	Institucioni i përmbahet kornizës kohore	2	
27 (b)	Institucioni u përmbahet shumicës së datave të rëndësishme në kornizën kohore	1,5	
27 (c)	Institucioni ka vështirësi që t'u përmbahet shumicës së datave të rëndësishme në kornizën kohore	1	
27 (ç)	Institucioni nuk u përmbahet afateve në kornizën kohore ose nuk e publikojnë kornizën kohore	0	
		<b>Gjithsej pikë të mundshme</b>	<b>Gjithsej pikë të fituara</b>
		46	0
	<b>Shkalla e transparencës së buxhetit</b>		
	A jeni të interesuar të merrni pjesë në seminar dhe vizitë studimore të një shteti anëtare e BE-së për mënyrën e implementimit të buxhetit të bazuar në performanca?		
	Informata për kontakt të nëpunësit të intervistuar		
	Telefon		
	E-mail		

#### FJALOR I TERMAVE TË PËRDORURA

**Buxheti i Republikës së Maqedonisë** është plan vjetor i të ardhurave dhe të hyrave dhe mjeteve tjera të aprovuara që përfshin Buxhetin qendror dhe buxhetet e fondeve.

**Buxheti qendror** është plan vjetor i të ardhurave, të hyrave dhe mjeteve tjera të aprovuara, ka të bëjë me shfrytëzuesit buxhetor të pushtetit qendror dhe përfshin

buxhetin themelor, buxhetin e donacioneve, buxhetin e kredive dhe buxhetin e aktiviteteve vetëfinancuese.

**Shpenzime** janë të gjitha pagesat (flukset dalëse) nga buxhetet për qëllime të miratuara, përveç pagesës së kryegjësë së kredive.

**Të ardhura** janë tatimet dhe pagesat e detyrueshme të caktuara me ligj, të hyra të cilat rrjedhin nga pronësia e mjeteve (interesi, dividende, qira, etj), kompensime për dhënien e mallrave dhe shërbimeve, dhurata, donacione, subvencione dhe transferta.

**Deficiti buxhetor** është dallim negativ mes të ardhurave të planifikuara, respektivisht të paguara dhe mjeteve të aprovuara, respektivisht shpenzimeve.

**Suficiti buxhetor** është dallim pozitiv mes të ardhurave të planifikuara, respektivisht të paguara dhe mjeteve të aprovuara, respektivisht shpenzimeve.

**Shfrytëzues buxhetor** janë shfrytëzues të linjës së parë në fushën e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, fondet, shfrytëzuesit e buxheteve të komunave dhe shfrytëzuesit e themeluar me ligj të cilëve u është dhënë detyra e kryerjes së autorizimeve publike.

**Fonde të buxhetit** janë: Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë, Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë, Fondi për rrugë magjistrale dhe rajonale dhe Agjencioni për punësim i Republikës së Maqedonisë.

**Klasifikim buxhetor** është paraqitje hierarkike e kodeve me qëllim të klasifikimit të funksioneve, njësive organizative, aktiviteteve dhe transaksioneve ekonomike në mënyrë të vetme dhe konzistente.

**Program** është grup i aktiviteteve të ngjashme të lidhura dhe projekteve që synojnë arritjen e një qëllimi ose qëllimeve të përbashkëta.

**Llogari përfundimtare:** Raport financiar i përgatitur në fund të vitit fiskal.

**Qarkore buxhetore.** Qarkorja shërben për përgatitjen e projekt-buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe përmban këto elemente: projeksione të agregateve makroekonomik të përfshira në Strategjinë fiskale të miratuar; prioritete strategjike të përcaktuara të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me propozim të programeve dhe nënprogrameve rrjedhëse të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë; shuma maksimale të mjeteve të aprovuara për shfrytëzuesit buxhetor të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë; udhëzime dhe drejtime për të përgatitur propozim të kërkesave buxhetore, plani i programeve për zhvillim dhe plani i vendeve të punës të sistematizuara dhe mbushura; dhe informata tjera të nevojshme.

**Output tregues:** Tregojnë se projekti apo aktiviteti realizohet me sukses dhe se parakushtet janë në vend për të arritur qëllimin.

**Tregues të rezultateve:** Kriteria të matshme që duhet të përmbushen me qëllim që programi t'i arrin rezultatet e veta.